LIGJ
Nr. 95/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, "PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12, pika 5, shkronja "a" ndryshon si më poshtë:

"a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.38 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.".

Neni 2

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 12/1

Përtej efektit në pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndryshimi në pagën referuese bazë i përcaktuar në nenin 12, pika 5, shkronja "a", të këtij ligji sjell efekte vetëm për pagën e anëtarëve dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas referencës në nenin 17, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar.

Për të gjithë funksionarët dhe nëpunësit e tjerë publikë, kur pagat e tyre referojnë te paga e gjyqtarit ose prokurorit, llogaritja kryhet duke marrë parasysh pagën referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 15, datë 17.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese.".

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 1.4.2023 vetëm për pagat e gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Miratuar në datën 18.9.2026.

Shpallur me dekretin nr. 495, datë 18.9.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj